

VENDIM
Nr. 31/2016

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJES SË
INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR NGA REALIZIMI I MARRËVESHJES PËR
ZGJIDHJEN ME MIRËKUPTIM NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRISË
“CEZ A.S.”**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesave financiarë të shtetit shqiptar, si dhe procedurave dhe rrethanave të nënshkrimit të marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a.s.”, të miratuara me ligjin nr. 114/2014, datë 31.7.2014, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1) Kontrolli i zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit publik, gjatë negociimit të marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a. s.”.

2) Njohja dhe verifikimi i pasojave financiare që ka sjellë marrëveshja për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a. s.”, si dhe identifikimi i përgjegjësisë nga organet apo personat zyrtarë përkatës, me synimin për frenimin me mjete ligjore të shfaqjes së tij në të ardhmen apo rregullimin e pasojave.

3) Njohja me dokumentacionin e plotë ligjor e financiar që ka përdorur grupi i punës gjatë negociimit të marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a. s.”.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke venë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratur në datën 14.4.2016